

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446/prot.

Tiranë, më 02.05.2023

VENDIM

Nr. 36 , datë 02.05 .2023

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT SIPAS KRITERIT EKONOMIK, FAZA IV, PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË
CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1328 prot., datë 20.04.2023 “Mbi miratimin e listave të studentëve që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023, sipas kriterit ekonomik, faza e katërt”, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e 9 (nëntë) studentëve, që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit, sipas kriterit ekonomik, faza IV, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total në vlerën 175,000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, përballohet nga Buxheti i Shtetit, si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.



MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ